



Duke u mbështetur në nenin 40.2 paragrafi 2 nën pikën e) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040 si dhe nenit 40 al.2 nën pikën 5) të Statutit të Komunës së Klinës, si dhe nenit 3 paragrafi 4.10, nenit 13 dhe 14 të Rregullores për përmbajtjen e simboleve, procedurën, mënyrën dhe kushtet për ndarjen e titujve të nderit, çmimeve, mirënjohjeve dhe shpërblimeve të tjera/2015, me kërkesën e Drejtorisë së Arsimit, Nr.110/2019, Kuvendi I Komunës së Klinës, në seancën e II-të të rregullt për vitin 2019, të mbajtur më datën 28.02.2019, mori këtë:

V E N D I M

**Për formimin e Komisionit vlerësues për ndarjen e Mirënjohjes "Frrok Gojani",
për mësimdhënës dhe nxënës me rastin e 7 Marsit-Ditës së Mësuesit**

- I. Formohet Komisioni vlerësues për ndarjen e Mirënjohjes "Frrok Gojani", për mësimdhënës dhe nxënës me rastin e 7 Marsit-Ditës së mësuesit.
- II. Komisioni ka këtë përbërje:
 1. Xhezide Trepça-Gashi-KK
 2. Elvira Sejdiu- "
 3. Saranda Elezaj- "
 4. Tush Dedaj- "
 5. Besim Hoti-Ekzekutivi
 6. Binak Syla- "
 7. Shoqëria civile
- III. Komisioni bën vlerësimin për ndarjen e Mirënjohjes "Frrok Gojani", në shenjë respekti atyre personaliteteve, të cilët kanë dhënë një kontribut të veçantë, të dallueshëm dhe të rëndësishëm në fushën e arsimit.
- IV. Kuvendi i jep mandat Komisionit që të kryej punën e vet në vlerësim për ndarje të çmimeve, mirënjohjeve dhe shpërblimeve tjera në fushën e Arsimit gjerë në fundin e mandatit të Kuvendit.
- V. Vendimi është i plotfuqishëm me miratim nga Kuvendi I Komunës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Më këtë Vendim njoftohen: MAPL, Kryetari, Drejtoria e Arsimit, Zyra për Informim, Shërbimi për punë të Kuvendit dhe Arkivi i Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË KLINËS

01Nr. 06-9313/2019
Klinë, më 06.03 2019

